



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 54 datë 26-06-2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË
DATËS 29 MAJ 2025**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës **29.05.2025** në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës **29.05.2025** bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 27-06-2025



-PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 29 MAJ 2025

Kryesuesi i mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 23

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 23

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe drejtorë të administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, mirë se keni ardhur në mbledhjen e rradhës të këshillit bashkiak. Rendi i ditës ju është shpërndarë gjithë këshilltarëve, kush është dakort me rendin e ditës?

Ju lutem këshilltarëve të votojnë.

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 23 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Vazhdojmë me pikën e dytë.

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 24 PRILL 2025.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 23 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-30 PRILL 2025.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në emër të komisionit znj.Jorida Rëmaçka.

Këshilltare J.Rëmaçka: Ditën e hënë komisioni u mbledh pasi shqyrtoi materialin vendosi ta kalojë për miratim dhe me të njëjtin sygjërim vijmë sot në këshill duke ju propozuar ta kaloni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit ka pyetje nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 24 këshilltarë, 24 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.166 DATË 24.12.2024 "MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA".

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë në emër të komisionit, ju lutem.

Këshilltare J.Rëmaçka: Në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës bëhet fjalë për tre familje, për një ndryshim referuar tre familjeve që sipas verifikimit të të ardhurave këta përfitues të bonusit të qirasë kanë rezultuar ndryshime si më poshtë:

Lirika Simaku ka ndryshim në masën e pensionit dhe kërkon ndryshimin e masës të mbështetjes të përfitimit në subvencionin e qirasë sociale dhe konkretisht do mbështetet me vlerën 5 mijë e 44 lekë në muaj nga 5 mijë e 121 që mbështetet deri tani. Luiza Nakoleci dhe Drinela Avdi kanë kaluar nga skema e mbështetjes në pension invaliditeti që konsiderohet kjo si e ardhur dhe Fiqirie Rizvani e cila në periudhën 1 janar -31 maj 2025 nuk ka përfituar bonusin bazuar në kontratën e qiradhënësit dhe sigurisht ka prishur kontratën në mënyrë të njëanshme, u votua ndryshimi në komision dhe sot vijmë me të njëjtin propozim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit ka diçka nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 23 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA.”

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë në emër të komisionit, ju lutem.

Këshilltare J.Rëmaçka: Bëhet fjalë për miratimin e skemës të strehimit, personat që përfitojnë strehim sipas subvencionit të interesave të kredisë, tabela është e paraqitur shumë saktë, përbërja familjare, struktura e banesës dhe vlera maksimale sipas të cilës e meritojnë. Komisioni e kaloi si material pasi e shqyrtuan dhe besoj se nuk kishte asnjë problem, nuk kishte asnjë problematikë, ne ishim të gjithë dakort.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Një pyetje dhe një koment të vogël sepse unë shikoj tabelat.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje e bëra pyetjen jo ka koment, nëse nuk ka pyetje fjala për koment.

Këshilltar K.Pllaha: Faleminderit, nga ana e shifrave sigurisht ekzekutivi punon saktë dhe e di më mirë se ne këto subvencionet por unë shoh se ndryshon masa e pensioneve, ndryshon subvencionimi i qirasë, ne duhet të flasim pak parimisht ndërkohë që inflacioni bën punën e vetë çdo çmim rritet, sa është mundësia që të ndryshojë edhe skema e subvencionimit për qirane e këtyre familjeve të pastreha sepse uljen e subvencionimit për shkak të rritjes të pensionit minimal që lidhet me pikën pararendëse por edhe me këtë nuk besoj se ndikojmë në përmirësimin e mirëqënies të këtyre familjeve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për ekzekutivin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Komenti ishte për materialin që miratuam më parë?

Këshilltar K.Pllaha: Të dyja materialet lidhen, mbase e kaluam në pika 5 është për subvencionimin e qirasë për familjet e pastreha, pika 4 ishte për një ndryshim se mbase keni kaluar tek 6.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pesa është për miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha.

Drejtoresha e Strehimit Social M.Balli: Përsëritet nëse e kuptova drejt atë komentin tuaj ne mund të ndryshojmë masën e subvencionit të qirasë në momentin kur miratojmë vlerën mesatare të qirasë maksimale në treg dhe kjo bëhet duke studiuar tregun ne këtë e bëjmë çdo vit bazuar tek kontratat që na paraqiten në zyrën tonë, gjithashtu edhe duke investiguar tregun vetëm kështu mund të ndryshojë ajo që ju komentoni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit nëse nuk ka diçka nga këshilltarët, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 6 e rendit të ditës.

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT “SUBVENCIONIM I INTERESAVE TË KREDISË”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe njëherë komisioni, ju lutem.

Këshilltare J.Rëmaçka: Eva besoj se kaloi si material tek të gjithë ky.

Në mbledhjen e fundit të komisionit patëm një ndryshim, u shtua një material ditën e hënë prandaj po pyes.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk është shtesë, është pjesa plotësuese, meqënëse në komision është kërkuar e kemi sjellë.

Këshilltare J.Rëmaçka: Pasi kaluam familjet të cilat përfitojnë nga subvencioni i kredisë e cila u miratua nga të gjithë, patëm edhe një shtesë për një qytetare e cila ishte tërhequr në mënyrë të njëanshme nga përfitimi i bonusit të qirasë për familjet e pastreha.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është për pikën 5 ajo që ju thoni u kalua. Ka pyetje nga këshilltarët nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

(Erdhi këshilltare Suela Dinellari.)

Pika 7 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NXËNËSIN RENIS MANKOLLARI, PËR PJESËMARRJEN E TIJ NË OLIMPIADËN NDËRKOMBËTARE TË MATEMATIKËS 2025.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në emër të komisionit, z.Habip.

Këshilltar A.Habip: Faleminderit znj.kryetare bëhet fjalë për subvencionimin që ekzekutivi do i bëjë një djali të talentuar që është nxënës tek Shkolla "Raqi Qirinxhi" viti i tretë, në olimpiadën e matematikës që do zhvillohet në Australi, shuma është 300 mijë lekë dhe bëhet fjalë vetëm për onoraret, shpenzimet për udhëtimin e nxënësit i cili do na përfaqësojë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se nuk ka ndonjë pyetje nga këshilltarët.

Këshilltar L.Petri: Përshëndetje znj.kryetare, doja të dija nga ekzekutivi pse është marrë për bazë programi i artit ndaj të cilit duhet të pakësohet kjo shumë dhe të shtohet për këtë qëllim?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se është kërkuar në sistem për pjesën e onorarit të biletave sa kushton.

Drejtorja e Financës V.Ziko: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Artikull, besoj se nuk ka ndonjë gjë. E hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstënim.

(Erdhi këshilltar Emiliano Muharem.)

Këshilltar L.Petri: Një koment, ju lutem.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po e votuam ta kishit bërë më parë komentin do ishte më mirë, megjithatë nëse e keni të nevojshme për ta bërë dhe sjell ndonjë ndryshim mund ta bëni.

Këshilltar L.Petri: Jo s'ka gje.

Pika 8 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E ANGAZHIMIT FINACIAR TË BASHKISË KORÇË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9-VJEÇARE "SOTIR GURA DHE NDËRTIM PALESTRE", ME CIKËL FINANCIMI 2025-2026.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në emër të komisionit, z.Habip.

Këshilltar A.Habip: Në shpalljen e thirrjes për financim e projekteve të programit bazë të Ministrisë të Arsimit, Bashkia Korçë ka fituar investimin për rikonstruksionin e Shkollës 9-vjeçare "Sotir Gura", vlera e plotë e projektit do jetë 11 milion e 315 mijë e 702 lekë, nga të cilat 80% do përballohen nga Ministria e Arsimit dhe 20 % nga bashkia, ky 20% do ndahet në dy vjet 10 % në vitin 2025 dhe 10% në 2026, vlera për vitin 2025 në të cilin do kontribojë Bashkia e Korçës është 12 milion 493 mijë e 834 lekë e cila

përfshin përveç rikonstruksionit dhe mbikëqyrjen e objektit si dhe kolaudimin, në rikonstruksionin e saj do jenë të përfshira gjithashtu dhe mobilimi si dhe laboraturët përveç ndërtimit të një palestere që do jetë si objekt shtesë, ndërkohë palestra e vjetër do përdoret për të shtuar kapacitetin e klasave ekzistuese. Ky fond do përballohet nga fondi i bashkisë për investimet në shkollat dhe arsimin parashkollor.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për t'i dhënë rëndësinë e duhur, besoj se ky është një lajm shumë i mirë për gjithë nxënësit, mësuesit, prindërit e shkollës "Sotir Gura" ne vazhdimisht aplikojmë tek thirrjet që hapen nga Ministria e Arsimit me projekte për rikonstruksione shkollash dhe vazhdimisht kemi pasur projekte që na janë miratuar dhe na janë mbështetur dhe këtë rradhë është rradha e kësaj shkolle e cila ka një numër të madh nxënësish të cilët janë në të njëjtën kohë edhe përfitues të këtij projekti dhe mësuesit, siç u tha edhe nga Altini projekti është një rikonstruksion i plotë i shkollës dhe i ambienteve të brendshme të saj, shtimin e një palestere të re dhe transformimin e palestrës ekzistuese në ambiente klasash dhe laboratoreve dhe shpresoj shumë që me këtë shtim klasash të kemi mundësi të zgjidhim edhe fenomenin e mësimi pasdite që për shkak të keq ekziston tek kjo shkollë sepse mbase është përqëndruar shumë numri i nxënësve, ndërkohë që në bashkëpunim me drejtorinë arsimore krahas rikonstruksionit do duhet të shohim edhe rishpërndarjen e nxënësve që punimet të ecin me shpejtësi, me cilësi që sa më shumë t'ju japim këtyre përfituesve një shkollë tërësisht të rikonstruktuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, z.kryetar, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Faleminderit znj.kryetare, unë kam disa pyetje në lidhje me këtë pikë. Pyetja e parë lidhet me faktin që unë dhe qytetarët kemi nëse për këtë projekt është bërë e mundur që tu imponohet tek zërat e zbatueshmërisë, krahas infrastrukturës që është për tu lavdëruar sepse çdo investim në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës vlen për mbarëvajtjen e arsimit, por për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve apo për udhëtime studimore për stafin, nuk është në tagrin e bashkisë e para dhe a është imponuar për panele fotovoltaike sepse këtu është ndoshta hera e 13 që unë e ngre që sa herë bëhen rikonstruksione të shkollave me gjithë vlerësimin që bëhet një punë e tillë, nuk merret parasysh trendi i kohës të sotme, ku ne vetë mblidhemi këtu dhe themi se një nga zërat më të madh të buxhetit lokal është për energjinë elektrike dhe nuk investohet tek ai drejtim, pra kur përfitohet një projekt i tillë a e kemi ne vetdijen dhe mos vallë ka erdhur koha që ta bëjmë kusht që të bëhet një projekt i tillë duhet të pajiset me panelet fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike, e para. E dyta doja të dija kush e zbaton dhe kush do e ndjekë këtë projekt?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka edhe një pyetje tjetër.

Këshilltar K.Pllaha: Sigurisht çdo investim në arsim është i mirëpritur, unë kisha një pyetje. Si është bërë përzgjedhja e kësaj shkolle sepse mesa mbaj mend në listën e prioriteteve nuk ka qënë e përmendur kjo shkollë kanë qënë shkolla të tjera "Naum Velqiharxhi", "Ismail Qemali" dhe ka munguar kjo shkollë. Kjo përzgjedhje është bërë në sygjërimin e drejtorisë arsimore apo vjen nga bashkia?

Këshilltar E.Fejzullah: Edhe unë patjetër e mbështes vendimin për të rikonstruktuar këtë shkollë dhe si ish nxënës i saj, ajo që doja të dija mbase dhe nuk i përket këshillit, doja të dija në momentin që kjo shkollë rikonstruktohet çfarë ndodh me nxënësit që janë atje, janë marrë masa për mbarëvajtjen e mësimi?

Këshilltare A.Përmeti: Një pyetje që e diskutuam dhe në komision por edhe sygjërim që a është menduar ndonjëherë nga pjesa e bashkisë që shkollat që rikonstruktohet të përfshihen në terenet e tyre dhe pjesa e sinjalistikës dhe lëvizjes pra të njihen nxënësit me sinjalistikën, lëvizjen urbane apo ato të cilat i bëjnë vetëm teori mund të ingranojmë shumë mirë nga shkollat edhe këtë pjesën dhe ata e përjetojnë këtë në jetën e tyre shkollore?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Projekti për rikonstruksionin e kësaj shkolle është përgatitur nga një kompani private, pra nga një studio private projektimi në kuadrin e bashkëpunimit që ne kemi patur me Usaid, pra ai ka mbështetur hartimin e projekteve të rikonstruksionit për disa shkolla në disa bashki të Shqipërisë dhe ne kemi paraqitur Shkollat "Sotir Gura", "Naum Velqirhaxhin", "Ismail Qemalin" mos gaboju dhe Demokracinë, projektet janë bërë nga këto studio dhe qëllimi i projektit të Usaid ka qënë të asistohen bashkitë që të përgatitin projekte të rikonstruksionit të shkollave sipas standartave bashkëkohore të projektimit të institucioneve arsimore dhe kjo i jep përgjigje edhe pyetjes që ka apo nuk ka panele fotovoltaike, vendoja e paneleve fotovoltaike nuk është kusht në projektim e një institucioni arsimor por thënë këtë unë si kryetar i bashkisë e kam vetëdijen e zbatimit të projekteve të efijencës të energjisë siç do bëjmë këtë vit me shkollën e Maltës, siç kemi bërë para dhe me projekte pilot si në "Raqi Qirinxhi" dhe "Sevasti Qirjazit" Çimi e ke informacionin?

Pra kemi bërë disa projekte pilot siç kemi bërë tek Shkolla e Maltës do bëjmë dhe tek shkollat e tjera dhe për projektet e efijencës të energjisë ka mundësi të gjenden edhe donatorë të tjerë mos financohen vetëm nga bashkia por të gjenden edhe donatorë të tjerë, kurse me këtë fondin që marrim nga Ministria e financojmë e ne me 20% të vlerës besoj se duhet të bëjmë përpjekjet maksimale që rikonstruksioni të përfshijë gjithë ato elementë konstruktiv të anës mësimorë aty brenda që janë të detyrueshme për standartet e një shkolle. Ky projekt nuk përfshin trajnimin e stafit përfshin vetëm rikonstruksionin sepse nuk është detyra e bashkisë fare në fakt është detyra e Drejtorisë Arsimore dhe institucioneve të tjera, zbatimi do bëhet nga kompani që do përzgjidhen nga procedurat e prokurimit, sot po miratojmë fondin dhe me miratimin e fondit i hapet rrugë zhvillimit të procedurave për të përzgjedhur kompaninë që do bëjë zbatimin e punimeve dhe kompaninë që do bëjë mbikëqyrjen e punimeve sepse të dy këto kompani në bazë të legjislacionit Shqiptar përzgjidhen nga proceset e prokurimit sipas kriterëve të legjislacionit përkatës në Republikën e Shqipërisë. Si është bërë përzgjedhja e shkollës e thashë ne kemi përgatitur projekte për 4 shkolla por kemi çuar këtë shkollë për shkak se kemi marrë parasysh edhe indikatorë që është numri i përfituesve që janë nxënësit edhe mësuesit por duke marrë parasysh edhe faktin që është shkolla e vetme që zhvillohet mësimi edhe mbasdite dhe shpresoj shumë që në bazë të këtij projekti një por edhe në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore duke bërë atë orientimin e nxënësve që frekuentojnë shkollat sipas afërsisë gjeografike me shkollat nga shtëpitë e banimit të këtyre nxënësve mos e kemi më këtë fenomen sepse kapacitetet e këtyre shkollave janë dhe ndodhin vetëm për shkak të mos shpërndarjes të mirë të nxënësve. Si do bëhet zgjidhja e procesit mësimor gjatë periudhës të rikonstruksionit, patjetër që çdo rikonstruksion shkolle ka këtë pjesën delikate dhe të vështirë pasi duhet të gjejmë mënyra se ku do zhvillohet procesi mësimor, nuk e kemi vendosur akoma është një bashkëpunim që bëjmë me Drejtorinë Arsimore nuk është se ka një formulë standarte përgjithësisht është bërë duke transferuar nxënësit tek shkollat e tjera dhe duke bërë mësimin pasdite është një sakrificë që duhet ta bëjmë për hir të të pasurit një shkollë të rikonstruktuar dhe me standarte. Në rastin e "Sevasti Qirjazit" që është një shkollë që rikonstruktua më fundmi u ndoq një tjetër rrugë u zhvillua mësimi në gjysmën e shkollës pasdite dhe gjysma u rikonstruktua pastajkaloi gjithë shkolla tek pjesa e

rikonstruktuar u bë mësimi paradite pasdite dhe u rikonstruktua pjesa tjetër, do ulemi do flasim me Drejtorinë Arsimore si do veprojmë me këtë shkollë. Përsa i takon sinjalistikës të lëvizjes dhe të mësuarit e nxënësve me mënyrën e lëvizjes nuk e kuptova mirë pyetjen, pra ideja është të vendoset një tabelë ku...

Këshilltar A.Përmeti: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk di të kemi diçka të tillë, po e keni diskutuar në komision dhe çfarë ka gjëra që janë në të mirë të projektit mund të përfshihen.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka pyetje, po z.Pllaha.

Këshilltar K.Pllaha: Me sa kuptova nga diskutimet, projekti është akoma në zhvillim pra nuk është përfundimtar besoj se është momenti që edhe në këtë projekt por edhe në të tjera përfundimtar të merren masa që shkollat tona të pajisen me facilitete për personat me aftësi të kufizuara nuk e di nëse janë marrë parasysh apo jo por edhe në shkollat e tjera mendoj se duhet të kemi tashmë një ashensor pasi mendoj se ju heqim të drejtën e arsimit disa personave me aftësi të kufizuara.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Qëllimi i projektit i Usaid ka qënë që të asistojë bashkitë që të hartojnë projektin e rikonstruksionit të shkollave që zbatojnë standaret aktuale të institucioneve arsimore, kështu që çfarë janë standarte që janë brenda këtij legjislacioni ok.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, kush e do fjalën për komente dhe diskutime?

Këshilltar L.Petri: Komentet e mia janë në dy drejtime një për ekzekutivin dhe unë e mirëkuptoj kur ai thotë se është një standart që e vendos Ministria por nga ana tjetër ne si njësi e qeverisjes vendore e kemi të drejtën, kemi tagrin, kemi detyrimin që të vendosim standartin tonë, fjala vjen për lagjet historike është jashtë standartit të ndërtohet dhe respektohet dhe është gjë e mirë në aspektin urbanistik, pse nuk po respektohet mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra ku po bëhen pallate dhe po shkatërrohet një trashëgimi historike dhe kulturore dhe e njëjta gjë duhet parë edhe në këtë dretjim ne mund të vëmë standartin që sa herë ka projektet e tjera tu thuhet po, por kushti bazë të bëhet edhe kjo, edhe ajo nuk besoj se ligji do kundërshtonte z.kryetar apo ekzekutivin nuk besoj se Ministria do kishte ndonjë kundërshtim përkundrazi do tregonim se e respektojmë veten, se ne para të gjithash respektojmë ligjin por kemi edhe kërkesa ekstra. E dyta kam një koment në lidhje me këtë projekt specifik nëse mund të përcillet personave që do merren dhe nëqoftëse do e konsiderojnë si një ide, shkolla në fjalë ka një oborr që zakonisht shkollat e tjera nuk e kanë në këtë veçanti, si Shkolla e "Themistokli Gërmenjit" ka dhe nënstrehime të cilat janë ndërtuar në kohën e diktaturës, ka shumë iniciativa sot sesi rifuqëzohen, rikualifikohen dhe përdoren në kontekstet aktuale këto hapësira, do sygjeroja që të merreshin në shqyrtim ata njerëz që kanë përvojë në këtë dretjim dhe të mund të rikualifikohej ajo zonë dhe të përdorej vetëm nga nxënësit, fjala vjen mund të rritin kërpuha atje, mund të ekspozojnë punimet që bëjnë dhe qytetarët mund të shkojnë t'i shohin, janë hapësira që dikur janë bërë që ne të pushtoheshim por sot mund të rikualifikohen dhe t'i përdorim për tjetër qëllim dhe do ju sygjeroja ose do ju lutesha që shollat që rikonstruktohet të kenë dhe një komision mirëmbajtje sepse për hir të së vërtetës kemi shembuj që kalon viti i parë, i dytë nuk mirëmbahen dhe topi kalon sa në një institucion në tjetri dhe nuk mbahet përgjegjësi, janë asete publike të cilat duhet shfrytëzuar edhe nga adultët fjala vjen edhe në këtë rast palestra mund të përdoret si një hapësirë reklacion sportiv edhe nga

adultët mund të gjendet formula shumë mirë kundrejt pagesës, kjo pagesë mund të shkojë për mirëmbajtje, është temë tjetër nuk dua të zgjatem por këto kisha, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, fjala për z.kryetar për një koment.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Para se të jap përgjigje për pyetjet që kanë nevojë për përgjigje, për atë çështjen e parë të prishjes të hapësirës publike dhe zënies me pallate kujt i referohemi konkretisht?

Këshilltar L.Petri: Faleminderit për pyetjen z.kryetar, i referohem zonës historike, Lagjes 1,2, 3, 11, 12 dhe atje ku ju banoni dhe jeni banorë dhe konkretish.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dhe cila lulishte është zënë me pallate?

Këshilltar L.Petri: Jo nuk përmenda lulishte z.kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përmende hapësira të gjelbra që janë zënë me pallate.

Këshilltar L.Petri: Përmenda hapësirën që duhet respektuarkur ndërtohet një objekt, ka pasur një oborr shtëpia dhe tani bëhet me 3 kate dhe oborri ikën dhe nuk po ngelet asnjë hapësirë e gjelbër në lagjet që ishin private por tashmë nuk janë më hapësira të gjelbra.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal hapësira brenda oborrit të shtëpisë po thua ti?

Këshilltar L.Petri: Po sigurisht.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo se kur thua po zihen hapëirat e gjelbra me pallate dikush që e dëgjon po thotë po zihen hapësirat publike me pallate, sepse ne si bashki dhe ju si këshill jemi përgjegjës të ruajmë hapësirat e gjelbërta publike, kurse si e mbjell unë apo ti apo dikush tjetër oborrit e shtëpisë e mban me pemë, me pllaka është çështje individuale jo e bashkisë që ti them unë do e mbash ti oborrit e gjelbër apo me pllaka.

Këshilltar L.Petri: Po thoni që është respektuar ligji në ndërtimtari?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Patjetër.

Këshilltar L.Petri: E vini dorën në zjarr për këtë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Megjithë veten time hy në zjarr për këtë sepse i nderuar z.këshilltar patjetër ti do jesh, unë do jem, të gjithë do jemi lejat e ndërtimit në bashki nuk jepen sipas dëshirës të kryetarit të bashkisë po ja u them në rast se nuk e dini por jepen bazuar mbi një dokument që ne kemi që është plani i përgjithshëm vendor i miratuar për bashkinë e Korçës që në vitin 2016 dhe unë nuk bëj dot asgjë edhe po të dua jashtë atij plani sepse shkoj unë, urbanistika, shkojmë në prokurori.

Këshilltar L.Petri: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të lutem mos më ndërprit sepse unë të dëgjova.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është e disata herë që këshilltarët kur marrin fjalën për diskutime dalin jashtë pikës të rendit të ditës, kjo nuk është për tu diskutuar tek kjo pikë jemi tek shkolla.

Këshilltar L.Petri: Znj.Kryetare faleminderit, unë e mora për analogji dhe z.kryetar po mbahet tek ajo pikë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Dëgjoni atëherë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kur e hap një pikë patjetër do dëgjosh, prandaj ja u kam thënë 100 herë dhe do vazhdoj t'ja u them Këshilli i Bashkisë nuk është kafeneja e lagjes kur ti thua diçka këtu duhet t'i dalësh zot, atëherë po them lejet e ndërtimit jepen sipas planit të përgjithshëm vendor dhe jemi të detyruar ta zbatojmë këtë gjë dhe për zbatimin e kësaj gjëje ne auditohemi vazhdimisht nga autoritetet që janë përgjegjës për këtë gjë, KLSH e të tjera dhe nuk bëj dot unë që të jap leje ndërtimi jashtë kriterëve të planit, në rast se ti nuk je dakort me kriteret e planit kjo është tjetër gjë, kur të vijë momenti për tu miratuar plani i ri, bëhet diskutimi, ndryshohet kriteret, të ulet koeficienti i shfrytëzimit, të ulet intesiteti, të rritet kjo, të ulet ajo por momentalisht ato janë të miratuara jam i detyruar ta zbatoj dhe tit ë më thuahs mos e zbato nuk e bëj dot, janë strikte dhe të përcaktuara nuk del dot njeri për ta kuptuar sesi funksinojnë këto lejet e ndërtimit se mbase në kafene e dini se funksinojnë ndryshe, kryetari i bashkisë është ai që firmos lejen në fund por parametrat janë të përcaktuara. Tani përsa i takon pjesës të ndërhyrjeve që mund të bëhen në shkollë i ndava në dy grupe, në grupin e ndërhyrjeve që duhet t'i bësh sepse janë të detyrueshme për të plotësuar një standart siç mund të jetë akses i fëmijëve me aftësi ndryshe është dhe ndërhyrja e vendosjes të paneleve fotovolataike të cilat po të duash i bën po të duash kjo nuk ka detyrim ligjor, mirë ishte t'i bënë të gjitha dhe strehimit t'i kthenim në ato ambiente që ti the por në fund fare është çështja e fondit sepse nuk jemi në kushtet që kemi një buxhet të pakufizuar unë atë buxhet që marr e filloj nga a-ja njëherë para se të shkoj tek zh-ja, ti thua merru me zh-në dhe pastaj po doli ndonjë lekë merru me a-në kemi një buxhet të përcaktuar dhe plotësojmë standartet si fillim pastaj gjërat që mund të jenë të mira mund të bëhen edhe më vonë dhe nuk çënojnë procesin mësimor po nuk u bënë, kjo është rradha dhe vlen për ta ditur, kjo është logjik dhe vendimarrja që duhet të marrë një kryetar bashkia, ku ta fillosh njëherë pastaj të shkosh tek tjetra, prandaj janë prioritetet, oborri i shkollës ja u dhashë përgjigjen. Nuk e di çfarë ka projekti për vend strehimet Çimi?

Nuk e prekim fare, pjesa e mirëmbajtjes është e rëndësishme sepse na ka ndodhur i kemi bërë rikonstruksionet e shkollave para dy vitesh mos e them emrin e shkollës dhe sa mbaroi rikonstruksioni hynë nxënësit që javën e parë shkatërruar tualetet e të tjera, Shkolla "Ymer Dishnica" që ta bëjmë më konkrete dhe duke nisur nga kjo eksperiencë e tmershme kam shkuar vetë kam takuar ata të shkollës, kam takuar drejtorinë arsimore dhe kemi bërë një standart tani të bashkëpunimit sepse nuk e ruan bashkia shkollën, dëmtimet vijnë nga përdorimi normal i shkollës dhe këto janë pjesë e mirëmbajtjes që bën bashkia dhe dëmtimet që vijnë për shkak të keqpërdorimit dhe kjo nuk është detyra e bashkisë sepse ne nuk mundemi të rrimë atje dhe t'i bëjmë sot të reja dhe ata t'i shkatërrojnë nesër, prandaj kam bërë takim me drejtorinë arsimore dhe kemi filluar me këto shkolla që kemi rikonstruktuar së fundmi ja u kemi bërë me dije drejtorave dhe mësuesve se do jenë ata përgjegjës për dëmet e shkaktuara jo nga përdorimi normal i infrastrukturës, drejtorët kanë bërë takime me prindërit ju kanë thënë që çfarë dëmtime do bëhen do kompesohen nga prindërit e fëmijëve përgjegjës, ne do bëjmë mirëmbajtjen rutinë që është detyra jonë, por edhe shkollat qëndër komunitare është një koncept që ekziston nuk e kemi shpikur ne, ideja e shkollës qëndër komunitare është se hapësirat e shkollës të jenë dhe në funksion të komunitetit, është diçka që e dimë dhe duam ta zbatojmë atje ku ka interes edhe nga shkolla edhe nga komuniteti.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënëse jemi në vijim të komentit po ja jap fjalën z.Lazjonit, pastaj z.Pllaha.

Këshilltar L.Petri: Kam vetëm një fjalë për z.kryetar dhe e falenderoj për gjithë këtë rezymë dhe i them nga kafeneja e qytetarëve është e pamundur ta konceptojmë sesi një ppv miraton një projekt si Belvederja fjala vjen, ju mund të thoni jo po e ka ligji, jo po e ka ppv, kafeneja e qytetarëve nuk e pëlqen Belvederen.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tani prapë jashtë teme nëse doni të bëni paralelizma bëni paralelizma me shkollat sepse jemi në pika e shkollave.

Këshilltar L.Petri: Po e le këtu diskutimin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka diçka nga këshilltarët, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

(Erdhi këshilltare Ismeralda Seidolli.)

Pika 9 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E ANGAZHIMIT FINACIAR TË BASHKISË KORÇË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT RIKONSTRUKSION I PALLATIT TË SPORTIT "TAMARA NIKOLLA", SHITESË KATI (PUNIME FASADE) ME CIKËL FINANCIMI 2025-2026.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Edhe ky projekt fitues i Ministrisë të Arsimit do përballohet 80 % nga Ministria e Arsimit dhe 20% nga Bashkia dhe ka të bëjë me rikonstruksionin e Pallatit të Sportit "Tamara Nikolla" bëhet fjalë për rikonstruksionin e fasadës dhe tarracës të këtij palati, vlera e projektit është 35 milion e 891 mijë 220 lekë ndërsa kontributi i bashkisë do jetë në vlerën 7 milion e 178 mijë e 224 lekë dhe kjo do përfshijë përveç kontributit të saj dhe mbikëqyrjen dhe kolaudimin e projektit, ky angazhim i bashkisë do përballohet nga fondi i planifikuar për investimet në shkollat e arsimit bazë parashkollor, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për kryetarin për të plotësuar në lidhje me këtë çështje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ky besoj se është lajmi i dytë i mirë që po japim në këtë mbledhje krahas rikonstruksionit të Shkollës "Sotir Gura" kemi aplikuar dhe për rikonstruksionin e Pallatit të Sportit është një projekt i shumëkërkuar dhe i shumëpritur jo vetëm nga pjesa e ekpive sportive që frekuentojnë por edhe nga sportdashësit të cilët po e frekuentojnë vazhdimisht edhe vitet e fundit edhe për shkak të rezultateve shumë të mira që ne si Klub Shumësportësh kemi në disa sporte siç është ai i volejbollit të femrave fillimisht dhe vitin e fundit edhe i meshkujve, pra është një projekt i rëndësishëm i cili do financohet nga dy burime fianncimi, burimi i parë është fondi që do miratojmë sot nga Ministria e Arsimit me të cilën do bëhet rikonstruksioni i fasadës edhe tarracës, ndërkohë Fondi Shqiptar i Zhvillimit do financojë rikonstruksionin e gjithë pjesës të brendshme të këtij projekti dhe në përfundim të dy

këtyre projekteve do kemi një pallat sporti tërësisht të rikonstruktuar edhe sipas standarteve bashkëkohore edhe për aktivitetet kombëtare por pse jo edhe për organizimin e aktivitetetve ndërkombëtare të lojrave me dorë, kemi pasur disa kërkesa nga Federata e Volejbollit, Basketbollit për të organizuar evente të ndryshme edhe Europiane kupa Ballkanike, kupa Europiane të moshave dhe besoj se kjo infrastrukturë e rikonstruktuar, e modernizuar do jetë e përshtatshme edhe për këtë qëllim, ju ftoj ta votoni këtë material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Sepse në relacion nuk ishte shumë e qartë por mesa kuptova nga fjala e kryetarit ne po miratojmë fondin për ristaurimin e tarracës ndërkohë Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një fond më vete që do bëjë pjesën e brendshme po a kemi detaje të tjera se çfarë përfshin ky rikonstrukcion dhe a do bëhen njëkohësisht të dyja sepse nuk besoj se është e gabuar nuk e di mbase ti mund ta japësh më të saktë, të ristaurohet nga jashtë pastaj të nisësh punimet nga brenda, nëse bëhen njëkohësisht ok?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje të tjera?

Këshilltare L.Alidinaj: Doja të theksoja për këtë projekt se është një projekt shumë i mirë dhe të tilla projekte të kemi sa më shumë dhe për rritjen e infrastrukturës por doja të theksoja këtu për këtë vlerën e angazhimit të Bashkisë Korçë që është 7 milion 787 976 lekë që do përballohet nga fondi i planifikuar për projekte në investime në programin e arsimit bazë parashkollor, bashkia me këtë strukturë buxhetore domethënë do pakësohet në vlerën kaq. Cilat projekte çënohen ose çfarë na mbetet pa bërë nga ky projekt që do i kalojmë këto fonde për pallatin e sportit?

Këshilltare A.Përmeti: Kam një pyetje në lidhje me pallatin e sportit, si është parashikuar ose si do jetë parashikuar sistemi i ngrohjes të pallatit sepse është zëri kryesor, do jetë me gaz meqënëse do bëhet gazifikimi, me energji elektrike apo do të jetë hibrid?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje të tjera, nëse jo, kryetar fjala për ju apo dikush nga ekzekutivi?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Pjesërisht unë, pjesërisht ata po e filloj nga pyetja e Lauretës po ta mbani mend kur kemi miratuar buxhetin ne kemi lënë një fond të padetajuar, të pa ndarë në zëra në fushën e arsimit dhe kur më keni pyetur atëherë ju kam thënë të njëjtën gjë që po e lemë këtë fond të pa detajuar sepse do aplikojmë edhe këtë vit si çdo vit në thirrjet që hap Ministria e Arsimit dhe këtë fond do e përdorim për të bashkëfinancuar këto projekte sepse besoj bën sens që në vend që të investohemi dhe të realizojmë projekte 100 % me fondet e bashkisë ne të lemë fonde që përdoren për të bashkëfinancuar projektet, prandaj vemë 20 %, qeveria ve 80 % dhe realizojmë një projekt që po të duhej të bëhej me fondet e bashkisë nuk do bëhej fare sepse ne kemi lënë 30 milion të reja në total ndërkohë që vetëm Shkolla "Sotir Grura" shkon 110 të reja prandaj dhe bën sens ky bashkëfinancimi nuk është se çënohet gjë i kemi lënë pikërisht për këtë qëllim të bashkëfinancojmë projektet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe janë dy projekte 1 në fushën e arsimit dhe 1 në atë të sportit. Kordinimi i punimeve është një çështje që e kemi pasur parasysh dhe po ecim paralelisht dhe pas këtij miratimi do të hapet rruga për të bërë prokurimin e fondit ndërkohë që edhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit është në momentin e prokurimit të fondit madje për ta bërë edhe më të mirë kordinimin edhe gjatë zbatimit meqënëse do jenë dy kompani që do përzgjidhen nga procedura të ndryshme prokurimi dhe nuk do jetë e njëjta firmë i kam kërkuar edhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit në rast se do kemi hapësirë ligjore që t'ja u delegojmë atyre edhe bërjen e procedurës, pra të gjitha këto bërja e procedurës dhe ndjekja e punimeve po mendoj që t'ja delegojmë Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe ne të firmosim vetëm atë

kontratën me subjektin dhe pjesën tjetër ta ndjeke fondi, në rast se do relaizohet ligjërisht kjo shumë mirë në rast se nuk do realizohet për problematika ligjore do përpiqemi t'i kordinojmë dy subjektet që janë në punë do bashkëpunojmë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit që të kordinojmë subjektet dhe zërat e punimeve të bëhen sipas rradhës që duhen bërë. Përsa i takon ngrohjes Çimi mund të thuash diçka sepse ngrohja është pjesë e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.kryetar nëse ka diçka tjetër nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Kisha një pyetje për pjesën e restaurimit të brendshëm që është nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit keni ndonjë informacion sesa ky fond i përcaktuar dhe në çfarë do shkojë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Vlerën finale nuk e kemi por do jetë shumë herë më e madhe sesa kjo e fasadës për shkak se atje jenë edhe pjesa e sistemeve, sistemi i ngrohjes dhe aspirimit di që është shumë i kushtueshëm si sistem, do jetë rikonstruksion i plotë i gjithë hapësirës shkallët, ambientet e brendshme, fushat çdo gjë.

Këshilltar K.Pllaha: Ndonjë afat përfundimtar?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sa e kemi ne Çimi kemi lënë ndonjë afat?

Drejtorja Urbanistike N.Hoxha: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Një vit po besoj, ky sezon besoj ta bëjmë tek Qyteza e Fëmijëve sepse është një sezon që nuk do bëhet atje besoj unë.

Këshilltar K.Pllaha: Për pjesën teknike Qyteza e Fëmijëve nuk besoj se është adapte për lojërat e nivelit profesionist.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në rast se nuk është do duhet të shkojnë pastaj tek këto pallatet e sportit Pogradec nuk e di por do marrë kohë patjetër sepse janë për tu bërë dhe procedurat e prokurimit sepse duan edhe ato kohën e tyre 2 muaj të themi, pastaj punimet një vit do shkojë minimumi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z.kryetar nëse nuk ka diçka tjetër nga këshilltarët, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 28 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 10 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË BUXHETIT NË VLERËN 100.000 LEKË PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “RECITAL AKTORIAL”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në emër të komisionit ju lutem.

Këshilltar A.Habip: Në kuadër të bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut, Këshilli i Qarkut ka financuar koncertin recital aktorial në vlerën 100.000 lekë për të mbuluar shpenzimet në stafin organizativ dhe në zërin kryesisht onoraret për të realizuar këtë projekt në nder të aktorit dhe regjisorit korçar Guri Koço, ai është një nga aktorët më të spikatur të 45 viteve të tij si aktor jo vetëm në teatër po edhe kinematografi ku ka lënë mbresa jo vetëm për qytetarët korçarë por dhe mbarë opinionin publik shqiptar, ky fond do i shtohet programit të Bashkisë për Qendrën e Artit dhe Kulturës dhe komisioni patjetër ju vton ta votoni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Patjetër do përdoret për këtë, faleminderit. Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Kam një pyetje për komisionin nëse kur u bë veprimtaria komisioni ishte mbledhur apo u mbledh pas saj sepse më rezulton që kjo veprimtaria është kryer dhe pyetja ime është pse duhet të ketë fuqi prapavepruese dhe pse anashkalohet këshilli bashkiak për këtë gjë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: T'ju jap një përgjigje të shkurtër sepse ky fond është miratuar nga Këshilli i Qarkut para se të bëhej ky aktivitet thjesht kalohet procedura nëpërmjet bashkisë.

Këshilltare A.Përmeti: Ne si këshill bashkiak e kemi të parashikuar këtë aktivitet dhe fondin i cili ka qënë në vlerën 450 mijë lekë, ndërkohë fondi që vjen është si e ardhur për bashkinë pra bashkia i shtohet fondi dhe ky fond shkon i dedikuar për këtë gjë sepse ka aplikuar pranë Qarkut dhe ai ja kalon bashkisë. Ne nuk miratojmë diçka që nuk është parashikuar por fondi shtesë vjen për këtë qëllim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka gjëra të tjera lidhur me këtë çështje?

Nëse jo e hedhim në votim, kush është dakort?

Më fal se nuk të pashë Zamira.

Këshilltar L.Petri: Përshëndetje Zamira doja të të pyesja sepse ka erdhur më përpara kolegja juaj Blerta dhe kemi ngritur në parim të njëjtën gjë, kur bëhen këto kërkesa ne jemi në nxitje të personaliteteve dhe në mbështetje sa kemi mundësi për artin do jetë e mundur që të na thuash se pse nuk i bëni me prevetiv të plotë dhe është ndonjë turp të thuash që onorarin për njërin e dhamë kaq për tjetrin kaq dhe nuk mendoni se kjo është transparencë por e lini të përgjithshme?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk ka lidhje me këtë more Lazjon, nëse keni pyetje mund t'ja bëni Zamirës më vete sepse kjo i kalon kompetencat.

Këshilltar L.Petri: Ju na ofroni një material ne si këshilltarë dhe na thoni që do bëhet kjo vendimarrje një pjesë e mirë e shumës të së cilës shkon për onorare po se për ke, sesi do bëhet nuk thotë fare.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E keni në material këtë pjesë, i është kërkuar Këshillit të Qarkut e detajuar dhe ai ka miratur këtë vlerë, kaq.

Drejtoresha e Qendrës të Artit dhe Kulturës Z.Kita: Guri Koço është një ikonë, ishte në nderin tonë që në këtë moshë të tij ta mundësonim realizmin e këtij recital dhe falenderoj Bashkinë dhe Këshillin Bashkiak që e ka miratuar, kjo shtesë është kërkuar vetë nga aktori Guri Koço Këshillit të Qarkut dhe falenderoj dhe kryetarin që ka nënshkruar kontratën midis Qarkut dhe Bashkisë dhe besoj se e meriton Guri Koço këtë pagesë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 27 pro, 1 kundër, 0 abstenim.

Pika 11 e rendit të ditës.

RAPORT I KONSOLIDUAR PËR VEPRIMATRINË FINANCIARE DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2024.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni në mënyrë të përmbledhur në lidhje me këtë material.

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka dërguar për miratim raportin e konsoliduar për veprimtarine financiare dhe zbatimin e buxhetit për Bashkinë Korçë për vitin 2024 në komision u bënë mjaft pyetje dhe u morën përgjigje si nga drejtuesi i financës dhe nga ai i të ardhurave për të nënvizuar është se ky raport që Bashkia ja jep për miratim këshillit është raport që rrallë e kanë bashkitë e tjera dhe ne si komision e vlerësojmë qoftë si akt vetëkontrolli por edhe si akt transparence dhe përgjegjshmërie ndaj qytetarëve të Korçës, komisioni vendosi t'ja kalojë këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka diçka në lidhje me këtë material?

Këshilltar L.Petri: Për procedurë znj.kryetare, këtu do votojmë vlerën, pra nëse përmbajtja e raportit është ok apo jo, apo miratimin e raportit në total?

Pra këtu pse po na ftoni të votojmë, pse u bë ky raport apo nëse jemi dakort me raportin apo jo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tani kur votohet ngrihet dora po apo jo për çdo material, kështu që keni pyetje për këtë material?

Drejtorja e Financës V.Ziko: Votimi është për raportin për shifrat që pasqyrohet atje ku çdo shifër është e kuadruar me thesarin dhe është detyrim ligjor që rrjedh nga ligji 68 për financat e vetëqeverisjes vendore neni 51 dhe 40 ku jep një pasqyrim të qartë të gjithë veprimtarisë ekonomiko-financiare të Bashkisë për vitin 2024 duke i krahasuar realizimin faktit të buxhetit me planin vjetor si dhe me vitin paraardhës, raporti vjetor i konsoliduar përmban analizë të hollësishëm financiare sin ë nivel të burimeve të financimit, në nivel të llogarive ekonomike të programeve dhe sipas institucioneve dhe risi e këtij viti është edhe si pas produkteve, buxheti është i realizuar në masën 76% në krahasim me planin vjetor dhe ka një rritje në krahasim me vitin 2023 prej 14 %, besoj se informacioni më i detajuar unë mund t'ju bëj një përmbledhje por paraqitet në raport, nëse keni ndonjë pyetje më thoni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje apo komente nga këshilltarët, nëse jo, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 24 këshilltarë, 23 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pika 12 dhe 13 kanë të bëjnë me informacion, pika 12 RAPORTI I MONITORIMIT JANAR-PRILL 2025 dhe pika 13 INFORMACION NË LIDHJE ME INVENTARIZIMIN E AKTIVEVE AFATGJATA, AFATSHKURTRA DHE MATERIALE TË BASHKISË KORÇË SI DHE NJËSIVE ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024 besoj se materialet i keni të lexueshme të shpërndara, kalojmë unë do thoja si fillim tek fjala e qytetarëve meqënëse ata na kanë ndjekur dhe pastaj tek pikat tona. Së pari po lexoj një kërkesë-ankesa të ardhur nga një qytetar z.Xhensil Shkëmbi i cili drejtohet dhe kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak, unë nuk po e lexoj gjithë përmbajtjen por konteksti i saj është që Shkollës Speciale t'i vendoset emri i mësueses Anxhela Latifi e cila u nda nga jeta disa ditë më parë. Në dijeninë time ka një komision i cili merret me vlerësimin e figurave dhe vendosjen e emërtesave dhe më pas pastaj dhe sillet në këshill për ta miratuar. Ka diçka nga ekzekutivi në lidhje me këtë çështje, për të bërë ndonjë koment ose për të bërë ndonjë sqarim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë nuk jam në dijeni mos ka erdhur direkt në këshill.

Këshilltar L.Petri: Po pse ishte ankesë znj.kryetare se u duk si propozim ju thatë kërkesë-ankesa.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.) Gjithashtu kërkoj nga Këshilli Bashkiak një kërkesë të ketë në vëmendje gjendjen tepër të vështirë ekonomike të familjes Latifi çdo formë ndihmë apo mbështetje institucionale do ishte e domosdoshme për këtë periudhë të ndjeshme për ta, kjo është kërkesa e ardhur nga z.Xhensil Shkëmbi.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e kam parë këtë paska kaluar tek Qendra e Artit dhe Kulturës është deleguar gabimisht andej, ta shohim si procedurë nga ana ligjore dhe vendosim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka dhe një kërkesë z.kryetar unë kam qënë në dijeni nga dita e djeshme, një grup familjarësh të cilat kanë persona me aftësi të kufizuar kryesisht ata të spektrit të autizmit që kërkojnë një mbështetje të specializuar nga Bashkia në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në qëndrën ditore të personave me aftësi të kufizuar por njëkohësisht edhe pse jo të një angazhimi tjetër për të qënë më gjatë atje dhe nga shërbimi komunitar që mund të bëhet nga individë të tjerë që vetë ofrohen për të dhënë shërbim tek kjo qëndër. Do doja t'ja jepja fjalën edhe për një sqarim më të plotë pasi unë nuk e kam kërkesën fizikisht, do ja u jap fjalën për t'ja u shpjeguar dhe këshilltarëve dhe kryetarit se cila është kërkesa juaj lidhje me këtë çështje.

Kërkesa e Shoqatës MEDPAK me përfaqësuese znj.Eleni Kotelli di i bashkëngjitet proceverbalit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jemi bashkë me shqetësimin tuaj dhe ju kam ndjekur vazhdimisht dhe me aktivitetet që ju zhvillon si shoqatë, unë do doja që fillimisht të bënte diçka në lidhje me këtë përfaqësuesi i drejtorisë të kujdesit social, ok atëherë fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani padyshim që unë e konsideroj atë kërkesën tuaj të drejtë në sensin që jeni dhe anëtarë të shoqatës por jeni në të njëjtën kohë familjarë të fëmijëve me aftësi ndryshe apo me spektrin e autizmit, duhet ta them se nuk është se nuk kemi bërë përpjekje dhe krahas qëndrave që kanë qënë ekzistuese jo më larg se para pak vitesh edhe me mbështetjen e Ambasadës Zviceriane kemi vënë në funksion edhe një qëndër të re pranë shkollës speciale që oforn.

Qyetetaria: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë e kuptova por po them se çfarë kemi bërë nuk është se e kemi patur jashtë vëmendjes dhe para disa vitesh kemi mundësuar hapjen e kësaj qëndre dhe në këtë kohë jemi përpjekur edhe ta fuqizojmë në kuptimin të shtojmë pak stafin sipas mundësive që kemi patur dhe të japim ndihmë dhe asistencë për një numër më të madh fëmijësh dhe familjesh por e vërteta është se edhe ajo qëndër nuk i plotëson të gjitha nevojat që ne kemi edhe për atë grupmoshë të fëmijëve i dhe ju me të drejtë thoni që ne i takojmë tani prindërve që interesohen për një grupmoshë më të rritur, për këta është ajo qëndra ditore, atelie që e përmendët e cila nuk pretendoj se ka kapacitetin për gjithë numrin e fëmijëve por do e kem në vëmendje dhe do përpiqem të bëj maksimumin edhe me donatorët edhe partenrët që kemi që të shohim se çfarë kapacitete mund të shtojmë dhe çfarë mund të përmirësojmë, nuk është se nuk e kemi dëshirën për t'ju ndihmur.

Qyetetaria: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.) Nuk na jep asgjë shteti, as sigurimet e pensionit për një shoqëri që do të hyjë në BE nuk është e drejtë, unë jam e shqetësuar për djalin tim se çdo bëmë pasi unë t'i mbyll sytë, ju përpiqeni të bëni më të mirën për ata që doni të bëni por jinni pak të ndjeshëm edhe për ne, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Duke menduar se çdo person këtu është po aq i ndjeshëm sa ju që e përjetoni në përditshmëri, do doja nëse ndonjëri nga këshilltarët për të dhënë ndonjë mendim lidhur me këtë gjë.

Këshilltare A.Përmeti: Do doja të thoja dy fjalë lidhur me këtë pjesë vërtet është një situatë që ne jemi përballur si banorë dhe mund të kemi dhe familjarët tanë, pas viteve 90 jemi njohur dhe kjo është diçka që po shtohet edhe mendoj se nuk është vetëm një gjë që Bashkia Korçë mund të merret por është diçka që lidhet me politikat shtetërore për ta mbështetur këtë grup shoqëror sepse çdo individ sipas kushtetutës ka të drejtën e tij t'i krijohen kushtet dhe mendoj mbase është e mundur që ne si këshill apo si bashki t'i drejtohem Ministrisë të Shëndetësisë çfarë ka në këtë drejtim sepse nuk e zgjidh një ambient që mund të krijojë bashkia, ajo do personel të specializuar, do politika sepse nuk është kaq e lehtë të trajtohen dhe nga informacioni që kemi nga jashtë që merren me këtë kategori duhet të ketë individë të specializuar që shoqërojnë këta, unë i mbështes zonjat por nuk mendoj se varet vetëm nga Bashkia sepse nuk është vetëm për sot por edhe për nesër, kështu që duhet të bëjmë diçka me qeverinë lidhur me këtë çështje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë këshilltar tjetër që e do fjalën për të dhënë një mendim në lidhje me këtë situatë për të qënë fjala vjen në një lidhje emergjente për t'i hapur rrugë zgjidhjeve afatgjata?

Këshilltar L.Petri: Unë jam një nga fansat e rinj të shoqatës dhe zonjave në fjalë sepse po i njoh edhe personalisht dhe jam përballur me ndjeshmëritë e tyre, hallet e tyre, më kanë folur me dorën në zemër nuk jam as i vetmi ka sigurisht këtu mes nesh që janë njohur me raste të tilla por realiteti është ky që zonjat e thanë dhe ne nuk kemi kemi si ta bëjmë të bardhën të zezë, pra për këtë kategori duhet ta pranojmë që si institucion dhe si shoqëri nuk kemi bërë gjë. Është e vërtetë që rritur vetëdija që nga

vitet 90 shoqëria është me e vetëdijshme në lidhje me këto hallet dhe spektrit të autizmit vetëm druaj se vëmendja jepet kryesisht për fëmijet e këtij spektri dhe në momentin që këta bëhen adultë lihen nën hije dhe harrohen dhe për më tepër nuk tregohet vëmendje as për prindërit e tyre sepse fjala që vjen mund të divorcohen dhe duhet të rrinë 24 orë të ditës me ta. Unë kam folur me zonjat dhe po ju bëj me dije edhe kolegëve këtu, unë nuk mund të them se çfarë mund të bëjmë ne si institucion por si shoqëri civile ne kemi nisur të lëvizim për të ngritur një grup vullnetarësh të cilët janë aktive dhe kanë empatinë për të shoqëruar këta grup njerëzish, në të njëjtën kohë të jenë të gatshëm që mund të trajnohen siç tha dhe znj. Përmeti shumë me vlerë sepse kërkon një trajnim shumë të veçantë kjo gjë duhet bërë skedari i çdo individi për të ditur jo vetëm se ku i ka fobitë dhe frikërat që të dish të reagosh në rast krize, por të dish edhe ku e ka talentin sepse zoti ta jep shkëlqimin në një drejtim të caktuar dhe ne do tregohemi shoqëri e emancipuar kur të dimë të ndezim talentet e personave me autizëm. Kështu që dhe unë po e bëj si thirrje nëse keni ndonjë ide apo njerëz që duan t'i bashkohen kësaj iniciative që tashmë ka nisur, ju them se ka dhe sipërmarrës privat që po vetë ofrohen për mjediset dhe unë jam dakort që u ngrit nga parafolësit këtu që nuk është zgjidhja e vetme ndërtimi i një objekti sepse e kemi diskutuar dhe herë të tjera sepse ajo është vetëm hardware çështja është tek software, a do jemi ne në gjendje, a i kemi kapacitetet që të ndërtojmë një program të skeduar dhe strukturuar shumë mirë me orare të përcaktuara ku të patronazhohet nga dy ose tre persona vullnetarë secili prej tyre, 15 janë në qytet pra 30 vullnetarë duhen, kërkoj nga ekzekutivi që të shikojë mundësitë e financimit të ekspertëve për të trajnuar këtë grup që ne po ngremë, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A. Verushi: Faleminderit, fjala për z. Nexhipi.

Këshilltar E. Nexhipi: Patjetër të dëgjosh prindër në këtë situatë prek por qasja ime është pak më e gjërë secili nga ne unë e kam thënë dhe herë tjetër nuk është imun ndaj kësaj situate, me dashje ose padashje dhe kur mos e kemi direkt në familje e kemi tek njerëzit e afërm dhe është një realitet që duam apo nuk duam ne është prezent, dikush që e ka në familje e përjeton më shumë ka atë merakun se çfarë ndodh kur nuk është prindi në këtë jetë dhe ai familjar do vazhdojë të ekzistojë. Nga studimi që kemi bërë këtë vit në kuadër të përgatitjes të planit rajonal social, kategorie e moshës 21-70 vjeç është kategoria e cila është e pa mbuluar dhe pa trajtuar nga shërbimet sociale, kuptohet nga rasti në rast ka specifika të ndryshme, dikush kërkon trajtim më të specializuar sepse mund të ketë mundësi integrimi, dikush tjetër kërkon shërbim ushtrimi, pastrimi dhe shoqërimi të vazhdueshëm por është një kategori që shoqëria jonë deri në këtë stad nuk ka arritur të sigurojë shërbim, nuk është vetëm çështje e bashkisë por e shoqërisë në tërësi që besoj pa i përjashtuar ato nevoja që ne i kemi thënë dhe trajtuar por vjen momenti që shoqëria duhet të shohë më shumë edhe këtë kategori. Ky problem nuk i takon vetëm bashkisë Korçë thashë, e njëjta situatë është tek të gjitha bashkitë e qarkut ku më shumë apo më pak, por e njëjta situatë është edhe në Shqipëri le të shërbejë ky diskutim por mos bazohemi vetëm në këtë për të sensibilizuar më shumë për të gjetur dhe zgjidhje të vogla sepse nga zgjidhjet e vogla vijnë të mëdha, unë personalisht jam i hapur që të le një takim së bashku të shohim ato mundësi që janë më të shpejta për tu bërë dhe sensibilizimi jonë i përbashkët të jetë deri dhe tek ndryshimi i ligjit në dijeninë time është duke u punuar nga grupet e interesit për ndryshime në ligjin e 2016 për shërbimin shoqëror social në Republikën e Shqipërisë dhe të llobojmë së bashku me përfaqësuesit që kemi në parlament por edhe me Ministrinë dhe pushtetin vendor për të ndikuar në modifikimet e këtij ligji dhe patjetër që nuk duhet të mjaftohemi vetëm tel empatia që kemi sepse asnjëri nga ne nuk është imun ndaj këtyre fenomeneve edhe unë sot jam mirë dola shkava atje tek shkallët e bashkisë u bëra si familjari juaj, kështu që nuk ka imunitet tek kjo çështje duhet ta ndjejmë dhe të bëjmë sipas mundësisë, unë e kuptoj hallin tuaj, e ndjej por nuk e zgjidhim dot duke thënë mos bëhen gjërat e tjera të bëhen të gjitha, ju lutem ta shikojmë që është e rëndësishme që të kemi një vëmendje të rëndësishme për këtë kategori

secili nga fëmijët tuaj ka një specifike të ndryshme por patjetër që ka dhe shumë të tjerë mbase më keq do një zgjidhje të përbashkët duke filluar mbase me ato pak mundësi që kemi këtu dhe të avancojë.

Qyetetaria: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar E.Nexhipi: I kam statistikën, është situatë për tu marrë në konsideratë dhe për tu paraprirë gjithë ndryshimeve që po vijnë, faleminderit.

Qyetetaria: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltare L.Alidinaj: Zonjat më kanë lënë pa fjalë me intuitën me emocionet që na kanë dhënë jeni gra shumë të forta, mua më keni emocionuar jashtëzakonisht shumë dhe si një nënë dhe keni mbështetjen time sado modeste dhe mesazhin e përcollet tek gjithë këshilltarët që janë dashamirës për t'ju mbështetur sado pak, të sensibilizohet për të marrë mesazhin dhe ju e përcollet dhe do vihen në lëvizje gjithë këshilltarët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po znj.dinellari.

Këshilltare S.Dinellari: Duke qënë se çështja që zonjat sollën në këshill është shumë sensitive dhe unë vlerësoj gjithë kolegët parafolës sepse secili prej tyre përfaqëson një institucion përveç këshillit, duke falenderuar kryetarin e Këshillit të Qarkut, Lazjonin që përsëri ka një iniciativë vetë si përfaqësues i një organizate që mund të vijë në ndihmë, unë do sygjeroja ndoshta kryetarit por edhe në bashkëpunim me ekzekutivin dhe këshilltarë të tjerë që këtë emergjencë po e quaj meqënëse zonjat e kanë disa vite këtë lloj shqetësimi të përfshihet dhe universiteti i cili diplomon studentë për shërbimet sociale dhe që mund t'i shërbejë në një plani strategjik për tu ardhur në ndihmë të rinjve apo të rriturve të kësaj kategorie, kështu që nëse do të ketë në një bashkëpunim ndër-institucional besoj se mund të kemi strategji të mirë veprimi, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, do ja jap fjalën kryetarit ka këshilltarë të tjerë?

Këshilltar K.Pllaha: Nuk e di nëse është specifike për spektrin e autizmit por ligji në Shqipëri ka vende pune të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara deri në 2% të punojësve me sa jam informuar, a është e zbatuar kjo në institucionin tuaj si bashki, apo institucione të tjera ku janë anëtarë të këshillit? E para njëherë duhet të mos ketë diskriminim për punësim, e dyta mund të përshaten kushtet e punës në orare të reduktuara, me mbështetje të tjera për të realizuar këtë pjesë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E rëndësishme është të jenë dhe të specializuar për atë punë, nuk është çështje shifrash.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ligji ka të përcaktime të asaj natyre por individët duhet të plotësojnë këto kushte që kanë gjithashtu edhe pozicione apo kriterë që kanë edhe pozicionet e punës dhe kërkesa e zonjave nuk ishte për t'i punësuar, ishte për tu ofruar shërbime sepse një kategori që nuk ka këtë specifike ajo është më tepër për personat me aftësi ndryshe në sensing fizik, nuk ka lidhje me kërkesën e zonjave, kërkesa e zonjave ishte që me rritjen e moshës, rriten edhe kërkesa e shërbimeve që ka individ i spektrit autik, ne kemi bërë një përpjekje të lavdërueshme, prandaj e përmenda, që para disa viteësh kemi hapur këtë qëndrën e specializuar për fëmijët e kësaj kategorie ku kemi specialistë logopedie dhe specialitete të tjera që asistojnë fëmijët por e pranoj që nevojat janë shumë të mëdha se kaq, edhe për këtë grupmoshë ka nevojë të rritet numri i atyre që përfitojnë nga këto lloj shërbime por edhe për

grupmoshën më të rritur dhe vazhdimisht e kemi diskutuar me partnerë, me donatorë të huaj sesi mund të rritim atë spektrin e përfituesve, me opsione të ndryshme që nga kombinimi me qëndrën ditore dhe ofrimin e shërbimeve në familje ku të shkojë tu ofrohet një shërbim i caktuar patjetër është një përpjekje që i tejkalon duhet ta them që tani përveç asaj sensibilitetit që është shumë i madh asnjëri nga ne çfarë do të themi me fjalë jam shumë i sigurt nuk mund të hyjë 100% në këpuçet e zonjave, duhet ta kesh në kurriz këtë gjë që ta kuptosh 100 % por përpiqemi ta kuptojmë dhe me një përpjekje jo shumë të madhe e kupton se çfarë situatë janë. Është një zgjidhje po e them që në fillim që i kalon mundësitë e një bashkie dhe kërkon përpjekje, edhe kordinim, edhe qasje nga institucione të ndryshme, Bashkia, Këshilli i Qarkut, donatorë të tjerë, shoqëria civile është shumë e mirëpritur dhe në rast se ka individë të tjerë që janë të gatshme që ofrohen vullnetarisht për të qënë shoqërues po e quaj sepse nuk di çfarë termi t'i ve në orare të caktuara, por kanë nevojë vetëm për trajnim, unë i mbajta shënim këto tre pika do flas me stafin e qëndrës tonë, me stafin e drejtorisë në rast se mund të bëjmë trajnim për persona të tillë, patjetër universiteti është i mirëpritur minimalisht në pjesën e trajnimit të vullnetarëve, maksimalisht edhe në mundësitë e tjera për të shtuar kapacitetet, përpjekjet duhen shtuar por se deri ku mund të shkojmë këtë nuk mund ta them tani sepse isha i pa përgatitur për ta diskutuar këtë çështje është shumë komplekse dhe e gjërë dhe kërkon informacion paraprak nga ana ime, cilat janë problematikat dhe çfarë kemi nevojë por këto gjëra që ju thashë i di nga puna ime e përditshme, patjetër që ka nevojë për disa gjëra unë i mbajta shënim dhe mbase në mbledhjen tjetër mund të them se cilat janë përpjekjet që kemi bërë dhe deri ku mund të shkojmë dhe çfarë kemi nevojë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofoni.)

Këshilltar L.Petri: Nëse mbaruat me këtë kam një kërkesë tjetër nga një qytetar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se zonjat e morën mesazhin tonë ashtu si morëm ne të tyre, kemi nevojë për një kosnultë të përbashkët ekzekutiv, këshill edhe shoqëri civile ka nga ata që vetë ofrohen dhe pastaj në mbledhjen e radhës të këshillit ne do japim informacion të plotë për mbështetjen që do ju japim ju dhe fëmijëve tuaj, atëherë vazhdojmë me këshilltarët.

Këshilltar L.Petri: Dua të vë në dijeni kolegët që kam marrë një telefonatë nga 1 qytetar korçar dhe kërkesën ma bëri nga telefoni sepse është shpërngulur dhe jeton në Selanik por arsyja që.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më fal do ju lutesha zonajve që materialin që ja drejtuar këshillit ta dorëzonit në sekretari për ta administruar dhe ju lutem vendosni për të lënë një takim me kryetarin e Këshillit të Qarkut, Lazjon më fal.

Këshilltar L.Petri: Zotëria më vuri në dijeni se është pronari i një trualli në të cilën ai ka investuar një kalçeto dhe ndodhet në rrugën Korçë-Bilisht kilometri i parë dhe në ato pak raste që ai kthehet në qytet ka pasur fëmijë që luajnë atje dhe i pyeti i tha po ju nga jeni nga Barçi, po ju nuk keni fushë në Barç jo i thanë ata dhe me tha se i lindi ideja dua ta le për qytetin këtë hapësirë kaleçetoje që ka , kështu që nuk e di si veprohet nga ana procedurale dhe mu lut që ta shohim se nëse është mundësia për ta arritur një kompromis që të ketë një reduktim të taksave që paguan sepse atje nuk jeton asnjëri ka një projekt me tre kate mos gaboj ku ka dhe hapësira sportive dhe thotë që unë po e le këtë për funksion të publikut dhe me mirëkuptim që këshilli bashkiak të më mirëkuptojë një ulje të taksave ne mund të shohim hapësirat ndoshta z.Prifti mund të na thotë diçka kështu që nëse duhet diçka shpresoj unë do i them të jape lejet e ndërtimit, kordinatat, mua më ka dërguar disa foto të kalçetos dhe objektit por janë foto të dërguara në komunikim privat nëse duhet diçka insitucionale më thoni.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vednore S.Prifti: Në lidhje në rastin në fjalë jemi njohur dhe më parë me kërkesat e zotërisë por asnjëherë nuk kanë qënë zyrtare por mund të them që kur ke një detyrim të akumuluar ndër vite nuk e di si mund të shpëtosh nga ky detyrim duke ja dhuruar këtë prone shtetit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe njëherë që ta kuptoj, ky do t'ja falë bashkisë apo do që ta lerë në përdorim?

Këshilltar L.Petri: Ta lerë në përdorim por e le pa qera dhe është në kushte të mira, është kalçeto e investuar thjesht ata nuk janë më atje që ta administrojnë si biznes dhe kërkon një marrëveshje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Domethënë nëpërmjet dhënies në përdorim të shpëtoj nga taksat e thënë shkurt.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do e shohim nga ana ligjore por nuk ka ligjërisht diçka të tillë që po ja u lë këtë dhe ju me hiqni nga taksat, si thonë asaj fjale nga taksat dhe nga vdekja nuk shpëton njeri, por ajo që mund të bëjmë është të bëjmë një llogaritje sesa kushton kjo po është se ne do e merrnim me qera dhe t'i bëhej zbritje kjo pjesë por duhet menduar.

Këshilltar L.Petri: Mua më lind ideja se kjo hapësirë të bëhet një regjistrim si pjesë e një shoqate de pastaj ka klauzola për shoqata të cilat kanë në objektin e tyre sportin dhe për këto ka ulje të tarifave apo jo?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani mesa kuptoj unë zotëria ka taksa të prapambetura, nëse ne do në këmbim të tyre prandaj duhet të thotë diçka.

Këshilltar L.Petri: Ideja është se nëse bëhet kjo marrëveshje të gjendet një mirëkuptim .

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Detyrimet e zotërisë mesa kuptoj unë të vendosura në kohë janë nga momenti x deri sot dhe nga sot dhe në vazhdim, tani diskutimi është nga momenti x dhe deri sot çfarë do bëhet me pagesën e taksave të prapambetura duhet të na i thotë zotëria, kurse në vazhdim duhet të shohim këtë gjë në rast se gjendet një mënyrë që ne e përdorim dhe vlera e tarifës të qerasë kompesohet me vlerën e taksave se bëhet llogaritje por që ta përjashtojmë nga taksat nuk e bëjmë dot sepse janë të përcaktuara në ligj se kush përfiton nga përjashtimi i taksës të pasurisë është me ligj, tarifat janë vendimmarrja jonë, taksat janë në ligj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka tjetër?

Këshilltare L.Alidinaj: Faleminderit znj.kreytare, dua paraqit disa kërkesa dhe shqetësime e qytetarëve nga takimet që kam kryer gjatë kësaj kohe, bëhet fjalë për banjot publike të qytetit në Parku "Rinia" dhe kishte turiste gra që donin të kryenin nevojat e tyre personale dhe ishte shumë e vështirë. Shqetësimi i dytë është se është bërë pastrimi i kanaleve deri tek Drejtorja e Buqësisë më tej është një zonë rrinë disa banorë nga Lavdari rruga e Voskopojës dhe nuk është mbaruar pastrimi i kanaleve deri në fund dhe unë pashë në atë zonë që kishin shumë fëmijë kishin shqetësimin dhe banorët e asaj lagjeje për një kalçeto ose fushë futbollit sepse nuk kishin hapësirë për të luajtur. Njëkohësisht kishin shqetësimin sepse është rrugë që kalojnë shumë makina dhe nuk kishin pjesën e trotuareve, ishin të shqetësuar nga aksidentet për fëmijët e tyre. Pjesa tek sih-konviketet është e rrethur një pjesë atje, kalçeto nuk e di është e pa mirëmbajtur është një zonjë që kujdeset për qentë dhe nuk lejon askënd të hyjë, nuk ka shërbimet e duhura tek Shkolla "Naum Velqiharxhi" i bie është një kalçeto, zonë sporti, tek ish- shkolla e

ndërtimit, tek ish-konviketet është një fushë sporti e rrethuar bari është rritur shume, është dikush që mban qentë dhe e administrojnë ajo si hapësirë publike, është e pa mirëmbajtur, bari i pa korur, është ambient i ndotur dhe nuk na shërben ne si qytetarë dhe pjesa tjetër është tek zona që thashë me këta njerëzit nga Lavdari që kanë zbritur, ata kishin pjesën e kanalizimeve atje krijoheshë shqetësim nga era e keqe dhe mushkonjat tani në verë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tek zona informale tek rruga e Voskopojës, kanalizimet i kemi bërë para tre vitesh.

Këshilltar L.Alidinaj: Në kanalet që kalonin atje i kishin të zbuluara dhe vinte erë e keqe dhe thanë duam të na mbulohen.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kur të mbaroni më thoni sepse flet ti, flet Ada, tek rruga e Voskopojës kemi bërë disa ndërhyrje në infrastrukturë, është zone informale e kemi filluar me projektin e kanalizimeve, ju kemi bërë dhe një kanal kryesor që shkon tek ky kanal anësor deri tek një farë vendi dhe pastaj kemi bërë dhe asfaltimin e të gjitha rrugëve në atë zonë, pra nga ana e infrastrukturës ndërhyrjet i kemi bërë me përjashtim të një rruge që na ka ngelur pa asfaltuar sepse grindeshin banorët me njëri-tjetrin, dikush kishte probleme me pronësi të një pjese të rrugës. Për pjesën e mbulimit të kanaleve, ato janë kanale kulluese, vazhdimisht e kemi pasur këtë kërkesën që të shikohet mundësia e mbulimit, nga diskutimet që kam bërë me specialistë të ujësjellësit ata më thonë se është gabim që të mbulohen këto kanalet e tokave buqësore sepse pastaj nuk i pastrojmë kur të ketë nevojë dhe mund t'ju shkaktojë përmbytje, këtë di si problem, di dhe që janë disa familje afër Drejtorisë të Buqësisë dhe nuk jam i qartë pse nuk janë lidhur tek ky rrjeti i kanalizimeve që kemi bërë para tre vitesh do e verifikojmë. Këtë pjesën e trotuareve ja u kam shpjeguar dhe atyre aksi Korçë-Voskop- Voskopojë është aks kombëtar nuk është aks i Bashkisë, e kemi bërë si kërkesë tek Autoriteti Rrugor Shqiptar që menaxhon këto akset kombëtare dhe shpresoj të ketë një financim të fillojnë këto trotualet, nuk e di nga ana teknike ka vend apo jo për trotualet atje sepse është asfalti pastaj kanali dhe nuk e di a ka vend ndërmjet asfaltit dhe kanalit, për kalçeto nuk ka vend sepse janë prona private dhe nuk kemi ku e bëjmë nuk di të kemi prona shtet atje. Pjesa e banjave publike e kemi shqetësim jo vetëm tek parku por edhe tek Lulishtja "Vangjush Mio" jemi në këtë situatën i investojmë na i shkatërrojnë nuk kma gjetur ndonjë zgjidhje por i kam menduar para vitesh këtë që të lemë një kujdestar, si t'ja bësh atij që e thyhen pa personali kur të dalë ai ti bjerë me sëpatë nuk ka çfarë i bën personeli, ai është i lulishtes shkon thyhen tualetine banjës. Në momenin që janë investuar nuk i ka lënë njeri pa dyer janë bërë me standart shumë të mirë dhe pastaj duhet menduar diçka.

Këshilltar L.Petri: Meqënëse u prek tema e vandalizmit dua të sjell në vëmendje Bulevardin "Rilindasit" ku sinjalistika vertiakle është e vandalizuar fillon që nga Lulishtja "Lëndina e Lotëve" dhe deri tek kthesa tek Malta fatkeqësisht tabelat e rrugëve kanë ngelur si art bashkëkohor një metalike kështu si U dhe në të njëjtën kohë ora e cila besoj është orë publike ka ngelur 6 pa 10 nëse kalon në mëngjes, nëse kalon pasdite unë e shoh 6 pa 10 po kështu që ju kemi lënë ju z.kryetar ne të kafenesë të qytetarëve këto shohim, kështu që këto doja të shtoja, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani për kafenenë e qytetarëve, sinjalistikën ok duhet e riparojmë, ora është dëmtuar, dëmtim i kohës kam folur me këta të ndërmarrjes të gjenin mundësi për ta riparuar me këto mundësi që kemi këtu nuk riparohet, besoj që duhet zvëndësuar, duhet marrë e re pjesa qëndrore, besoj se nuk e riparonim dot, nuk është se nuk e kam parë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, duke menduar se dhe shqetësimet tani në fund i trajtuat, mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI


